



BULETINI INFORMATIV

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

SHKURT 2024

SHPËRNDARJA E CERTIFIKATAVE PËR STUDENTET E KLINIKAVE TË LIGJIT



Certifikuam 34 studentë të angazhuar pranë Klinikave të Ligjit, për vitin 2023, të cilët kryen praktikën 2-mujore të punës pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore.



Takim me Kryetaren në Detyrë të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri zj. Clarisse Pasztory, për nënshkrimin e marrëveshjes së mirëkuptimit, si dhe përgatitja e një udhëzuesi për ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore, mbi mënyrën e komunikimit dhe pritjes së qytetarëve të kategorive vulnerabël.



Ministria e Drejtësisë & Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas zhvilluan përgjatë datave 15-22 shkurt 2024 fushtën e ndërgjegjësimit *"Për mbrojtjen e viktimave të krimit"*.



Tiranë

Aktivitet informues pranë Ministrisë së Drejtësisë.



Vlorë

Ministri i Drejtësisë, z. Ulsi Manja dhe Drejtori i Përgjithshëm i DNJF, z. Ergys Qirici zhvilluan takim me kryetarin e Bashkisë z. Ermal Dredha dhe përfaqësuesen e Qendrës Psiko-Sociale Vatra.

Berat Shkodër

Takim me temë *"Fuqizimi i grave dhe vajzave përmes rritjes së aksesit në të drejtat ekonomike, ligjore dhe sociale"*, në kuadër të programit *"Barazia Gjinore në aksesimin e mundësive ekonomike"*, zbatuar nga Expertise France, financuar nga AFD.



Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mori pjesë në një Sesion Konsultimi me temë *"E drejta e aksesit në drejtësi dhe barazi e mosdiskriminim në perspektivën e qytetarëve dhe monitorimeve të KSHH"*



Intervistë e dhënë nga specialistja zj. Irma Alushaj për Radio Tirana, në emisionin *"Unë, mundem"*.



QSHNJP Vlorë, në kuadër të javës për mbrojtjen e viktimave të krimit, priti vizitën e Ministrit të Drejtësisë, z. Ulsi Manja, Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF, z. Ergys Qirici dhe të Kryetarit të Bashkisë Vlorë z. Ermal Dredha.

QSHNJP Vlorë zhvilloi në datën 07.02.2024 një takim pranë Bashkisë Selenicë, Njesisë Administrative Kotë, me përfaqësuesit e Bashkisë si dhe me qytetarë të kësaj njësie



QSHNJP Vlorë zhvilloi në datën 19.02.2024 një takim me drejtoreshën e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social Vlorë zj. Irena Stasa si dhe Kordinatorën e Njesisë për Dhunën në Familje.

QSHNJP Vlorë mori pjesë në seminarin e datës 12.02.2024 organizuar nga Instituti për Studime Publike & Ligjore (ISPL) me temë *"Integriteti Gjyqësor"*.

QSHNJP Vlorë zhvilloi në datën 27.02.2024 një aktivitet informues me qytetarë të qytetit, në kuadër të Javës kundër Diskriminimit.



QSHNJP Pogradec organizoi në datën 19.02.2024 një aktivitet me nxënësit e gjimnazit "Gjergj Pekmezi" në kuadër së javës të ndërgjegjësimit, me temë *"Mbrojtja e Viktimave të Krimit"*.



QSHNJP Pogradec zhvilloi në datën 09.02.2024 në qytetin e Pogradecit, një sesion informimi "Street Low" me qytetarë të grupmoshave dhe kategorive të ndryshme.

QSHNJP Pogradec organizoi në datën 19.02.2024 një aktivitet me nxënësit e gjimnazit "Gjergj Pekmezi" në kuadër së javës të ndërgjegjësimit, me temë *"Mbrojtja e Viktimave të Krimit"*.



QSHNJP Lushnjë mori pjesë në datën 06.02.2024 në një aktivitet të organizuar nga njësia e integritetit, Bashkia Lushnjë, me rastin e *"Ditës së internetit të sigurtë"*.



QSHNJP Kukës organizoi në kuadër të javës së ndërgjegjësimit për mbrojtjen e viktimave të krimit, një aktivitet informues me qytetare të kësaj kategorie dhe punonjës të Shërbimit Social si dhe me Koordinatorën për dhunën në familje dhe barazinë gjinore .



QSHNJP Korçë realizoi në datën 15.02.2024, në zbatim të Strategjisë Ndërsëktoriale të Mbrojtjes së Viktimave të Krimit, në bashkëpunim me Institucionet Vendore një video mesazh sensibilizues për të treguar mbështetjen tonë ndaj kësaj kategorie të veçantë .



QSHNJP Korçë në datën 01.02.2024, mori pjesë në takimin e realizuar me psikologët e shkollave të Bashkisë Korçë.

QSHNJP Korçë në datën 27.02.2024, mori pjesë në takimin e realizuar në ambientet e shkollës "Naim Frashëri", nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bashkëpunim me projektin e përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillin e Evropës *"Fuqizimi i mbrojtjes nga Diskriminimi në Shqipëri"* me mbështetjen e programit të Instrumentit Horizontal III i cili mbështet organizimin në Shqipëri të *"Javës kundër Diskriminimit 2024"* .



QSHNJP Elbasan organizoi në datën 01.02.2024, në kuadër të promovimit të shërbimeve që ofron Qendra, një aktivitet street- law në qytetin e Elbasanit.

QSHNJP Elbasan organizoi në datën 19.02.2024, në kuadër të javës *"Për mbrojtjen e Viktimave të Krimit"* një leksion I hapur pranë Fakultetit Ekonomik Elbasan me studentët e departamentit të së drejtës.



 **QSHNJP Lezhë** zhvilloi në datën 02.02.2024 një aktivitet *"Street Law"* nëpër rrugë të ndryshme të qytetit të Lezhës, me qëllim informimin e qytetarëve në qytetin e Lezhës.



QSHNJP Lezhë mori pjesë në datën 17.02.2024, në aktivitetin e organizuar nga Ministria e Drejtësisë në kuadër të *"Javës në mbrojtje të viktimave të krimit"* u inagurua edhe muralesi në qendër të qytetit, nga Ministri i Drejtësisë, z.Ulsi Manja.



QSHNJP Lezhë mori pjesë në datën 06.07.2024, në seminarin mbi të drejtën penale për të mitur ku morën pjesë Prokuroria Lezhë, Organet e policisë Lezhë, Kurbin dhe Mirditë.

QSHNJP Lezhë organizoi në datën 20.02.2024, në kuadër të *"Javës në mbrojtje të viktimave të krimit"*, në bashkëpunim me organizatën Terre de Hommes, një takim informues mbi Ndihmën Ligjore Falas dhe kategorive përfituese nga ky ligj.



 **QSHNJP Përmet** organizoi në datën 21.02.2024, në kuadër të *"Javës në mbrojtje të viktimave të krimit"*, një aktivitet pranë sallës së Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e koordinatorës së dhunës në familje, përgjegjësin e këshillit rinor, juristen e bashkisë.

 **QSHNJP Kurbin** organizoi në datën 19.02.2024, në kuadër të *"Javës në mbrojtje të viktimave të krimit"*, një aktivitet në bashkëpunim me Komisaratin e Policisë Kurbin me tematikë fuqizimin e komunitetit të Kurbinut dhe mbrojtja e viktimave të krimit.



 **QSHNJP Berat** organizoi në datën 22.02.2024, në kuadër të *"Javës në mbrojtje të viktimave të krimit"*, një aktivitet në qytetarë të kategorive të ndryshme përfituese.



 **QSHNJP Tropojë** organizoi në kuadër të *"Javës në mbrojtje të viktimave të krimit"*, një takim me përfaqësues nga Komisarati i Policisë, Bashkia Tropojë, Shërbimi Spitalor dhe Shërbimi Përmbarimor

QSHNJP Tropojë zhvilloi një aktivitet *"Street Law"* në kuadër të aktiviteteve promovuese.

QSHNJP Tropojë, në kuadër të aktiviteteve promovuese, zhvilloi në datën 22.02.2024 një takim me Administratorin e Njesisë Administrative Llugaj Z.A.Çakrraj dhe specialistë pranë këtij institucioni.



QSHNJP Tropojë zhvilloi në datën 29.02.2024 një takim me stafin e Qendrës Shëndetësore Llugaj, mbi tematikën e viktimave të dhunës, të abuzimit seksual dhe personat me aftësi të kufizuara, të cilët kanë kontakt të drejtpërdrejtë me personelin shëndetësor.



 **QSHNJP Gjirokastrë** zhvilloi në datën 12.02.2024, një aktivitet pranë Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, në bashkëpunim me Shoqatën Multifunksionale për Kulturë Edukim dhe Zhvillim (MKEZH). Aktiviteti gjithashtu u shoqërua dhe me pjesëmarrjen e medias lokale RTGJ. <https://youtu.be/QjPgytf2WsY?si=SSQEkre0-befOyrE> RTGJ (media lokale); <https://youtu.be/odJjQ3gut4A?feature=shared> RTSH (media kombetare).

 **QSHNJP Tiranë**, në kuadër të Javës për mbrojtjen e viktimave të Krimit, mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, i cili kishte për qëllim informimin e qytetarëve, kryesisht viktimave të krimit dhe të miturve mbi të drejtat që ata gëzojnë dhe mënyrat se si mund ta "luftojnë" një krim që po kryhet kundrejt tyre.



 **QSHNJP Shkodër** zhvilloi në datën 08.02.2024 një takim informues me të mitur në Qendrën Atelie me një grup të miturish të cilet janë pjesë e Qendrës Atelie.

QSHNJP Shkodër zhvilloi në datën 23.02.2024, në bashkërendim me OJG Shoqata Para-Tetraplegjikve në Shkodër, me prezencën e përfaqësuesve të OJF-eve lokale dhe shërbimit social të Bashkisë Shkodër.



QSHNJP Shkodër mori pjesë në datën 13.02.2024 në një takim informues, të organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

QSHNJP Shkodër organizoi në datën 20.02.2024, në kuadër të “Javës në mbrojtje të viktimave të krimit”, një takim në bashkëpunim me Terre des Hommes, me të rinjtë e Shkolles “At Gjon Karma”, Njesia Administrative Guri i Zi.



QSHNJP Shkodër zhvilloi në datën 20.02.2024, në kuadër të “Javës në mbrojtje të viktimave të krimit”, një takim me punonjësen e Komisarariatit të Policisë Shkodër.


QSHNJP Shkodër zhvilloi një aktivitet informues, në bashkëpunim me Shkollën e Mesme të Përgjithshme “Nënë Tereza” Bushat dhe shërbimit social të Bashkisë Vau Dejës.



 **QSHNJP Fier** organizoi në kuadër të “Javës në mbrojtje të viktimave të krimit”, një aktivitet në ambientet e Drejtorisë Rajonale të Policisë Fier si një nga aktoret kryesor për të bashkëpunuar për temën “Rritja e aksesit në drejtësi për viktimat e krimit nëpërmjet ofrimit të ndihmës ligjore falas”..



QSHNJP Fier mori pjesë në dy aktivitete të zhvilluara në kuadër të Javës Kundër Diskriminimit 26.02.2024- 01.03.2024. Aktiviteti i parë u zhvillua në ambientet e shkollës së mesme “Janaq Kilica” dhe aktiviteti tjetër u zhvillua në ambientet e Agjensisë Kombëtare të Punësimit, ku ishin të ftuar disa institucione.




 **QSHNJP Mat** realizoi në kuadër të “Javës në mbrojtje të viktimave të krimit”, në datën 14.02.2024 një njoftim zyrtar në television lokal Mat.

QSHNJP Mat realizoi në kuadër të “Javës në mbrojtje të viktimave të krimit”, në datën 15.02.2024 një takim me specialisten e Bashkisë Mat, Sektori i Barazisë Gjinore, Dhunës në Familje dhe Mbrojtjes së Fëmijëve.

QSHNJP Mat zhvilloi në datën 20.02.2024 një takim me temë “Drejtësia sociale dhe viktimat e krimit”, ku morën pjesë disa banorë të qytetit të Burrelit.

QSHNJP Mat zhvilloi në datën 27.02.2024 një takim me qëllim sensibilizimi për viktimat e fenomenit të diskriminimit.



 **QSHNJP Pukë** realizoi në kuadër të “Javës në mbrojtje të viktimave të krimit”, në datën 21.02.2024 një takim me kordinatorët e Bashkisë Pukë, si dhe me përfaqësues të Komisarariatit, Përmbarrimit, Shërbimit të Proves, si dhe funksionarë e qytetarë të shtresave të ndryshme.

QSHNJP Pukë mori pjesë në datën 09.02.2024, në një takim me temë “Për dhunën në familje”.



QSHNJP Pukë në datën 14.02.2024 mirëpriti pranë Qendrës z.M.Bardhoshi, Kryetar i OJF-eve për paratetraplegjikët të rrethit Pukë.

QSHNJP Pukë në datën 15.02.2024 organizoi një takim pranë Njesisë Administrative Rrape, me temë “Aksesi i qytetarëve në drejtësi dhe informim për funksionin e QSHNJP Pukë.

QSHNJP Pukë në datën 20.02.2024 organizoi një aktivitet “Street Law” në Bashkinë e Fushë-Arrëz, duke zhvilluar edhe bashkëbisedime të shkurtëra me qytetarë të ndryshëm.